

UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT  
VENDIM

Nr. 15 , Datë 30/07/2021

MBI

**“MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT AKADEMIK TË UART ME KOHË TË PLOTË, ME KONTRATË, ME KONTRATË ME KOHË TË PJESSHME DHE ME NORMË TË REDUKTUAR, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN 2021 - 2022”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 40 pika 1/gj., duke qënë se punësimi i personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ, në të gjitha nivelet në Arsimin e Lartë bëhet me konkurrim publik. Bordi Administrimit pasi shqyrtoi dokumentacionin përcjellë nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ku, Autoritetet drejtuese të njësive kryesore të Universitetit të Arteve të tre fakulteteve, sipas kërkesave të bëra nga përgjegjësit e Njësive Bazë përkatëse, të cilët, pas përfundimit të vitit akademik dhe pas miratimit të parashikimit të ngarkesës mësimore (norma dhe mbinorma sipas akteve në fuqi), për vitin akademik pasardhës, evidentuan nevojat për personel akademik/me kontratë/me kontratë me kohë të pjesshme dhe normë të reduktuar. Kërkesat për vendet e lira të punës dhe analizat përkatëse për çdo pozicion pune ardhur me shkresat Nr. 740 prot., datë 05/07/2021 ( FM 110/5 Korrik); Nr. 860/6., datë 05/07/2021 (FAB 58/ 5 Korrik); Nr 853 dhe 853/1/ 7 Korrik, (bashkëlidhur vendimit), në mënyrë unanime,

Bordi i Administrimit pasi shqyrtoi Relacionin e shoqëruar me shkresë (Vendimi i SA nr. 13/28.07.2021) te Rektorit të Uart Prof. Kasteriot ÇAUSHI, e diskutoi dhe me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e shtesës numrit të personelit akademik me kontratë me kohë të plotë, për çdo Fakultet sa më poshtë:

➤ Fakulteti i Muzikës në aktualisht ka **85 punënjës mësimorë**; Shtesa për vitin akademik 2021 – 2022, do të jetë **7 punonjës mësimorë**;

Numri i përgjithshëm i personelit akademik bëhet **92 (nëntëdhjetëdy) punonjës**.

➤ Fakulteti i Artit Skenik aktualisht ka **43 punënjës mësimorë**; Shtesa për vitin akademik 2021 – 2022, do të jetë **10 punonjës mësimorë**;

Numri i përgjithshëm i personelit akademik bëhet **53 (pesëdhjetëtre) punonjës**.



UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

- Fakulteti i Arteve të Bukura aktualisht ka **37 punonjës mësues**; Shtesa për vitin akademik 2021 – 2022, do të jetë **5 punonjës mësues**;  
Numri i përgjithshëm i personelit akademik bëhet **42 (dyzeteshtatë) punonjës**.

*Numri i përgjithshëm i personelit akademik në Universitetin e Arteve do të jetë - 187 (njëqindëntëdhjetë e dy) punonjës akademik. (sipas lidhjes bashkëlidhur)*

*Numri i përgjithshëm i personelit administrativ sipas vendimit të BADB 2017 nuk do të ndryshojë ai është - 80 (tetëdhjetë) punonjës administrativ. (sipas lidhjes bashkëlidhur)*

2. Miratimin e Numrit të personelit me kontratë, me kontratë me kohë të pjesshme dhe me normë të reduktuar për secilin fakultet sipas shkresave sa më lartë si dhe shkresës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për nevoja të shërbimeve të ndryshme që nuk mbulohen nga personeli i brendshëm, sa më poshtë vijon:

- Fakulteti i Muzikës - **98 (nëntëdhjetë e tetë) punonjës mësues** sipas lidhjes 1 bashkëlidhur vendimit;
- Fakulteti i Artit Skenik - **37 (tridhjetë e shtatë) punonjës mësues** sipas lidhjes 2 bashkëlidhur vendimit;
- Fakulteti i Muzikës - **19 (nëntëmbëdhjetë) punonjës mësues** sipas lidhjes 3 bashkëlidhur vendimit;
- DMBNJ, punonjës me kontratë për nevoja të shërbimeve të ndryshme **10 (dhjetë) punonjës**.

*Numri i përgjithshëm me kontratë, me kontratë me kohë të pjesshme dhe normë të reduktuar në Universitetin e Arteve do të jetë - 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) punonjës .*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT**

3. Ky vendim shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Risena Xhaja (Kryetar)**



---

**Prof. Besnik Bisha (Anëtar)**



---

**Prof. Arben Basha (Anëtar)**



---

**Aida Martiro (Anëtar)**



---

**Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)**



---

**Lorenc Vangjeli (Anëtar)**



---

**Vladimir Llakaj (Anëtar)**

---

